

# Gëzimi i fëmijëve apo fëmijët e gëzuar?

Sami ISLAMI

30 janar 2010

## Përmbledhje

Në këtë artikull bëhet fjalë për përdorimin e këtyre dy sintagmave në funksion semantik (kuptimor), që sipas mendimit tonë, duke u përdorur në vende të caktuara ndërron edhe kuptimi i tyre. Pastaj bëhet fjalë edhe për përdorimin e fjalës **dëshmor** dhe **martir**, që shpesh po përdoret me kuptime të kundërta a në fakt këto janë sinonime. Po ashtu përdorimi gabim i foljes **mposht**, emrit **vktime** etj.

Dihet se gjuha është një organizëm i gjallë. Duke qenë në kontakt me gjuhët e tjera ajo, në njëfarë mënyre "komunikon" duke marrë, por edhe duke i dhënë fjalë njëra-tjetrës. Edhe shqipja i është ekspozuar këtyre marrëdhënieve. Por kur të kihet parasysh se sa fjalë të huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe, sidomos gjatë këtyre viteve të fundit dhe sa po vazhdojnë të hyjnë pa asnjë kriter, mund të themi se gjendja është shumë shqetësuese, madje do të thoshim alarmante!

Po kësaj radhe nuk do të ndalemi t'i shqyrtojmë këto ndikime të huaja në leksik (fjalor). Kësaj radhe do të ndalemi tek një kategori fjalësh apo konstruktesh të tjera, të cilat, sigurisht e iritojnë secilin që ka ndërgjegje gjuhësore të formuar. Në anën tjetër, këto konstrukte duke u përdorur shpesh lehtë mund të futen thellë në gjuhë, sa një ditë këto mund të na duken si diçka krejt "*normale*", edhe pse në fakt nuk duhet të zënë vend, me këtë trajtë e kuptim në gjuhën letrare.

Para disa kohësh u organizua një festival i këngës për fëmijë në televizion, i cili mbante titullin "**Fëmijët e gëzuar**". Dua të mendoj pozitivisht se organizuesit e festivalit e kanë pasur me qëllim të mirë që mesazhi i këtij organizimi t'u dedikohet të gjithë fëmijëve pa dallim. Por me "fëmijët e gëzuar" a thua vallë u përfshinë të gjithë fëmijët? Në shikim të parë duket se s'ka asnjë dallim këtu, por po të shikohet më thellë del se këto dy sintagma dallojnë rrënjësisht njëra nga tjetra. Sepse nëse themi "fëmijët e gëzuar" automatikisht ne, me vetëdije apo pa të, i kemi ndarë fëmijët, disa "*të gëzuar*", e disa, "*të pagëzuar*". Le ta formulojmë ndryshe këtë sintagmë! Le të themi "**gëzimi i fëmijëve**". Konstrukti i dytë, s'do mend se është ai i cili do të duhej të përdorej, sepse ky nuk i ndan fëmijët në "*të gëzuar*" dhe në "*të hidhëruar*"! Unë pajtohem se në botë ka fëmijë edhe të gëzuar e edhe jo të gëzuar, por ama këto konstrukte përdoren për rrethana dhe kontekste të tjera, por kurrsesi në kontekste të tilla, siç ishte festivali, i cili parimisht iu dedikua, kujtoj, të gjithë fëmijëve pa dallim.

Mungesa e një gjuhëtari ose profesionisti gjuhësor, i cili do të ishte kompetent t'i kontrollonte tekstet e gazetarëve, para se emisionet, lajmet etj. të transmetoheshin në publik, bën që të dalin, po ashtu, edhe gabime të tjera kuptimore (semantike), që ta vrasin veshin. Shpesh më ka rënë të dëgjoj në media fjalën "**dëshmor**" dhe "**martir**". Në mediat tona këto dy fjalë përdoren shpesh si fjalë me kuptime të ndryshme, por në fakt këto dy fjalë e kanë të njëjtin kuptim, pra janë sinonime. Sikur që janë sinonime fjalët "*vajzë*" dhe "*gocë*", "*djalë*" dhe "*çun*" etj. Mjaft dendur mund të dëgjohen konstrukte si: "U bënë homazhe dëshmorëve dhe martirëve të kombit" Ose " Në luftën e...ranë kaq dëshmorë e kaq martirë"! Ne mund të themi "U bënë homazhe dëshmorëve ose martirëve të kombit", ose "Në luftën e...ranë kaq dëshmorë ose martirë", por jo si në shembujt e mësipërm. Prandaj duhet pasur kujdes që kur shkruajmë ose kur flasim ta përdorim, si njëri, po ashtu edhe tjetri, por me kuptim të njëjtë e jo të ndryshëm <sup>1</sup>.

Fjala "**viktimë-a**", që ka prejardhje latine dhe që përdoret në shumë gjuhë indoevropiane, përdoret edhe në gjuhën shqipe. Po çuditërisht nuk është në asnjë fjalor të gjuhës shqipe(!). Nejse. Nuk do të merrem këtu me këtë problem, se po të hyjmë në këtë fushë do të na marrë një kohë të gjatë për ta shqyrtuar. Por, ajo për çfarë do të flas këtu është se shpesh kjo fjalë po del (në të shkruar dhe në të folur) gabim. Cili është kuptimi i kësaj fjale? Kuptimi është ky: "*Lëndimi ose vrasja e një njeriu apo shtaze si rezultat i krimi*". Pra viktimë, quhet personi i pafuqishëm përballë një force, një dhune dhe si rezultat kjo (viktima) pëson dëm, plagoset ose zhduket fare nga dhuna. Në gjuhën e shtypit dhe të mediave të tjera shpesh mund të hasen konstrukte si "*U vranë ose u masakruan shumë viktima të pafajshme*"(!). Së pari, duhet të kihet parasysh se vetë fjala "*viktimë*" e ka në vete edhe pjesën tjetër "e pafajshme". Se nuk ka viktimë "të fajshme"! Kjo është njësoj sikur të themi "akull i ngrirë" ose "borë e ftohtë! A ka akull të shkrirë dhe borë të ngrohtë?!

Një problem më vete paraqet edhe përdorimi gabim i fjalëve "**mund**" apo "**mposht**", të cilat po përdoren edhe në kuptimin "fitoj"(lojën) ose "ngadhënjej" etj. Edhe pse këto dy fjalë mund të merren si sinonime, prapëseprapë, këto nuk janë të tilla, ose më mirë të themi, nuk bën të trajtohen të tilla. Për shembull, fjala (folja) "**mund**" mund të përdoret në kuptimin "*ngadhënjej*", "*fitoj*", "*mposht*". Pra ka përdorim më të gjerë. Ajo mund të përdoret edhe kur është fjala për sport , pra lojë, por edhe kur është fjala për luftë kundër armikut, kundër sëmundjes, kundër së keqes, kundër frikës e kështu me radhë<sup>2</sup>. Nderkaq fjala (folja) "**mposht**", përdoret për të "*mundur*" *armikun, sëmundjen, të keqen, frikën* etj., por nuk duhet të përdoret kur është fjala për sport, pra për lojë<sup>3</sup>. Këtu është edhe ndryshimi. Etika sportive nuk e duron të shprehemi me, p.sh. "*Prishtina e mposhti Dritën*". Sepse kjo është lojë, është sport. Asnjëri ekip nuk është i rrezikuar për vdekje nga njëri-tjetri. Kurse, kur është fjala e ballafaqimit me armikun, me sëmundjen etj., situata është ndryshe. Armikun duhet të përpiqesh që ta "*mposhtësh*", ta "*hedhësh për tokë*", ta "*vrasësh*", se nëse nuk e bën ti atëherë armiku do të mposht ty. Kur jemi tek sporti, pra, pse të mos e përdorim një term më njerëzor, më sportiv, si "*Prishtina e mundi*

<sup>1</sup>Shih *Fjalorin e shqipes së sotme*, Tiranë, 2002, f. 235.

<sup>2</sup>Shih *Fjalorin e shqipes së sotme*, f. 815.

<sup>3</sup>Po aty f. 811.

"Dritën", ose "Prishtina ngadhënjeu kundër "Dritës", ose "Prishtina" fitoi ndaj "Dritës" etj. Jemi të mendimit që përdorimi i termit "**mposht**" i tejkalon raportet sportive, pra të lojës. E sporti, siç dihet, është aktivitet human, pra njerëzor, e jo armiqësor.

Disa reklama televizive, janë aq banale sa çuditë se si nuk i shohin ata njerëz që punojnë aty! A kanë në këto redaksi njerëz që, së paku, e kanë të kryer shkollën e mesme? Se nuk ka nevojë fare të jesh apo jo gjuhëtar për t'i vërejtur dhe për t'i evituar këto fjali absurde. Në një program televiziv që reklamohej qumështi "vita", p. sh. më ka rënë të dëgjoj edhe fjali si këto: "*Për ata që duan të rriten!*"? *Pra, bleni qumështin "vita" në qoftë se doni të rriteni!*" "*Për ata që duan të rriten të shëndoshë!*"?, Ose tek emisioni "*Kënaqësia e gatimit*" mund ta dëgjosh edhe këtë reklamë: "*Për ata që duan ushqim të shëndoshë!*"? Ose edhe një tjetër: "*Komjet Shala ju ndihmon në testet teorike dhe praktike edhe në rastet më të vështira!*"? Sipas kësaj del se "Komjet Shala", le që ju ndihmon në raste të lehta, por edhe në rastet më të vështira! Domethënë kjo autoshkollë i bën krejt punët vetë për ju ( i kryen edhe punët e lehta edhe punët e vështira)! Pra ju vetëm paguani të hollat dhe patentën e keni në xhep! Po a kanë mend ata që i përgatisin këto reklama? A janë duke e kuptuar se çfarë janë duke thënë? A thua a janë këta zotërinj shqiptarë apo të huaj, që rastësisht kanë hyrë në televizion dhe nuk e kuptojnë mirë shqipen!? Po kush (cili fëmijë) nuk dëshiron të rritet?! Kush nuk do të rritet i shëndoshë?! Dhe në fund a ka ndonjë njeri që nuk do ushqim të shëndoshë, po ushqim jo të shëndoshë?